



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 02/2026

I Mbajtur në takimin e II-rë të rregullt të Kpf-së me datën 26.05.2026, në sallën e e takimeve në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, dhe Zyrtares për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përsëritet për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, , të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të KPF-së. Po fillojmë me mbledhjen e II-rë të rregullt të KPF-së dhe për këtë mbledhje propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e Kpf-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Kpf-së;
4. Propozim – Vendim për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve në Komunën e Ferizajt;
5. Propozim – Vendim për Miratimin e Raportit të Vlerësimit të Dëmeve materiale nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
6. Propozim – Vendim për Miratimin e Raportit të Vlerësimit të Dëmeve materiale nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, të shkaktuara nga Temperaturat e Ulëta dhe Ngricat në fidanishtet e Pemëve;

7. Propozim – Vendim për Shpallje Interes i Përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale; 57-

5, 57-3, 152-1, 62-1, 63-6, 63-4 Z.K.Sazli, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 350-0-0 Z.K. Sazli, pronë e Komunës së Ferizajt;

8. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrës kadastrale; 1793-0 Z.K.Ferizaj pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 1794-0 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt;

9. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale; 615-2, 614-4, 616-6 Z.K.Sojevë, pronë private, me qëllim të këmbimit me ngastrën kadastrale 611-0 Z.K. Sojevë, pronë e Komunës së Ferizajt;

10. Propozim – Vendim për rishqyrtimin e Vendimit me Nr.01.Nr. 41 të datës 30.04.2025 i pezulluar sipas Vendimit me Nr. 01.Nr. 89 të datës 30.09.2025;

11. Propozim – Vendim për emërtimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në Ndërmarrjen publike N.L.P. “ Ambienti” SH.A. Ferizaj;

12. Propozim – Vendim për emërtimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në Ndërmarrjen publike N.L.P. “ Stacioni i Autobusëve” SH.A. Ferizaj;

13. Propozim – Vendim për emërtimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në Ndërmarrjen publike K.R.M. “ Pastërtia” SH.A. Ferizaj;

14.Të ndryshme.

Kryesuesi pyeti nëse ka dikush diqka rreth rendit të ditës dhe drejtoresha e financave Sebahate Ajeti Sadiku theksoi që e ka një pikë të re për ta futur në rend të ditës që është bartja e të hyrave vetanake nga viti paraparak në këtë vitë pasi ka tejkalim të planifikimit.

Kryesuesi meqenëse ska tjerë rreth rendit të ditës e qes në votim këtë rend të ditës se bashku me propozimin për bartje e THV dhe kaloi me 7 vota për 00.

Sa i përket procesverbalit ska vëretje dhe kaloi me 8 vota për 00.

Kryesuesi e lexoi pikën e 4 dhe ia kaloi fjalën drejtorit të urbanizmit Arbër Bytyqi i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që kjo pikë ka të bëjë me plotësim të listës pasi kan ndërruar jetë disa figura dhe është mirë ti plotësojmë me emra dhe kush do që ka emra për ti propozuar urdhëroni.

Brahim Osmani theksoi që pas takimeve që kam patur me bashkëluftar të Ilir Konushefcit pasi i njëjti ka qenë edhe dhanderr i Ferizajt dhe nëse nuk është në listë propozoj që të jetë.

Pasi ska tjerë propozime kjo pikë kalon për në kuvend me 8 vota për 00.

Kryesuesi e lexoi pikën e 5 dhe ia kaloi fjalën për diskutim Arian Imeri pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që në këto raporte përfshihet edhe fitimi i humbur dhe shpresoj që mos të jetë këtu pasi atë nuk bënë të përfshihet.

Burim Bajrami thekson që ky vlerësim u bë në koordinim me AME dhe sipas rekomandimeve të tyre është bërë ky vlerësim.

Kjo pikë kaloi me 6 vota për 00.

Kryesuesi e lexoi pikën e 6 dhe pasi spati të interesuar për diskutim u hodh në votim dhe kaloi me 6 vota për 00.

Kryesuesi e lexoi pikën e 7 dhe fjalën e morri Festina Sadiku e cila pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që para se me fillu ky emri i Ilir Konushefcit eshte ne list pasi eshte ne gjeoportal ndërsa sa i përket pikës fillimish jemi tu i shfuqizu dy vendime që janë marrë paraprakisht dhe tani pi këmbejm nga fillimi pasi është bë inplementimi i rrugës dhe duhet ta komensojme dhe kjo është par si forme.

Ejup Delolli theksoi që në gjeoportali vërehet që ka shumë probleme p.sh vijat e prekin edhe parcelat tjera a keni me pas vazhduar me kësaj probleme pasi mujm ndoshta me një veprim mi kry të gjitha.

Drejtoresha theksoi që në momentin që kemi kërkesa do të shqyrtojmë.

Kjo pikë kaloi për kuvend me 6 vota për 00.

Kryesuesi e lexoi pikën e 8 dhe ia kaloi fjalën drejtoreshës Festina Sadiku e cila theksoi që kjo pikë ka të bëjë me këmbim për shkak të projektit zgjerimi i tretuarit e keni edhe në skicë.

Kjo pikë kaloi me 6 vota për 00.

Kryesuesi e lexoi pikën e 9 dhe Drejtoresha theksoi që edhe kjo pikë ka të bëjë me këmbimin e pronës si në propozim në sojeve dhe do të bëhet fillimish vlerësimi e pastaj të shikohet për këmbim. E kemi edhe pëlqimi nga banka.

Kjo pikë kaloi me 6 vota për 00.

Kryesuesi e lexoi pikën e 10 dhe fjalën e morri përsëri drejtoresha e lartëcekur e cila theksoi që kjo pikë ka të bëjë me herët e miratuar ka ardhur si e pa ligjshme pasi preambula ka qenë gabim dhe tani ka ardhur e përmirësuar dhe e procedojmë kështu.

Kjo pikë kaloi me 6 vota për 00.

Sa i përket pikës së BTHV fjalën e merr Sebahate Ajeti Sadiku e cila pasi përshëndeti të pranishmit thekson që ka patur tejkalim të mjeteve të planifikuar si në raport janë rreth 2 milion e 300 mij euro dhe i kemi nda në kategorit si në raport ku kemi patur nevojë dhe e dini që jemi në kolaps për shkak të përmbarimeve.

Kjo pikë kalon me 6 vota për 00.

Kryesuesi thekson që pikat 11,12 ,13 i diskutojm bashk pasi janë emërimi ianëtarve të aksionarve në ndërmarrje publike, dhe debatin besoj që është mirë ta diskutojmë në kuvend.Kaloi me 6 vota për 00.

Në të ndryshme Brahim Osmani propozon që të sjellët raporti i auditimit pasi i njëjti nuk ka ardhur për diskutim dhe meqenëse është dokument i rëndësishem duhet të vij me patjetër.


Kryesuesi e shpall të mbyllur këtë mbledhje të kpf-s

Procesmbajtjesi:


Leutrim Mahmuti



Kryesuesi i Kk-se


Xhavit Zariqi